

# SISTEMI EMËROR I TË FOLMES SË ISTOGUT<sup>1</sup> ME RRETHINË

## Hyrje

Sistemi emëror në arealin gjuhësor të Istogut me rrethinë nuk ndryshon shumë nga ai i gjuhës letrare, por as nga të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, mirëpo, krahasuar me shkrimet e vjetra të shqipes, dallimet janë të theksuara, p.sh.: numri më i vogël i rasave, ndryshimet në kategorinë e emrave asnjane, formimi i shumësit të emrave mashkullorë, si dhe disa lëkundje te mbaresat rasore. Kur kemi të bëjmë me sistemin emëror në arealin në shqyrtim, në mjaft raste vihet re paranyjëzimi i emrave, sidomos ata që tregojnë prejardhjen a origjinën e një njeriu, përkatësisht të një banori, p.sh.: *i vrëllsi* (banori i Vrellës), *i prigódsi* (banori i Prigodës), *i lÿbóvsi* (banori i Lubovës) i *rakóshsi* (banori i fshatit Rakosh) etj. Ngjashëm, si në Istog, kemi hetuar se paranyjëzimi i emrave del edhe në të folmen e Plavës e të Gucisë<sup>2</sup> e në ndonjë të folme tjetër.

## 1. Kategoria e gjinisë

Për sa i përket truallit gjuhësor të Istogut, të gjithë emrat i takojnë njëres prej gjinive gramatikore. Shumica e gramatikave të shqipes, ndër to edhe ajo e Akademisë<sup>3</sup>, gjininë e cilësojnë si një prej kategorive gramatikore më karakteristike për emrat në gjuhën shqipe, që dallohet nga kategoritë e tjera gramatikore të emrit, siç janë numri, rasa, kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë, sepse kundërvënia mashkullore-femërore-asnjane ka të bëjë me gjithë klasën e emrave përgjithësisht dhe shfaqet në shpërndarjen e tyre në gjini të ndryshme dhe jo me forma të ndryshme të së njëjtës fjalë.

1 Këtu janë marrë për bazë 52 fshatra të komunës së Istogut.

2 Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Plavës dhe e Gucisë*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2002, f. 118.

3 Grup autorësh, *Gramatika I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 88.

Kur jemi te gjinia e emrave, është me interes të vihet në dukje fakti se shqipja e sotme është e prirë që të kalojë nga sistemi tri gjinish në atë dy gjinish, siç po ngjet me disa gjuhë indo-europiane, edhe me rumanishten, si njëra prej gjuhëve ballkanike.

## 1.1. Gjinia mashkullore

Gjinisë mashkullore i takojnë ata emra që në trajtën e pashquar përfundojnë me bashkëtingëllore, kurse në të shquarën marrin mbaresën – **i** ose – **u**; p.sh.: *mal-mâli, bu:rr-búrri, shök-shóku, mík-míku* etj. Grupin e emrave mashkullore e ndërtojnë edhe të atillë emra që në trajtën e pashquar mbarojnë me ndonjërin nga bashkëtingëlloret **k, g, b**; p.sh.: *shteg, mik, brisk, oxhak, sokak, trumcak, breg, Beleg* (oronim në bjeshkët e fshatit Kaliçan), *berllog, strufulllog, Sofrabeg* (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Cërkolez), *krah, shah* (shahu) etj., ndonëse bashkëtingëlloret fundore **b** tek emrat e përmendur është zbehur dhe shqiptohet jo e plotë, pra si gjysmë **b** <sup>(h)</sup>. Të gjinisë mashkullore janë edhe disa emra, tema e të cilëve del me zanore të gjatë, si: *thi, m., shi* etj., si dhe disa emra të përveçëm njerëzish që përfundojnë me **i** të shkurtër e që lakohen sipas paradigmes së lakimit të tretë; p.sh.: *Sadri, Fazli, Imri, Kadri, Sejdi, Nuri, Nuh* etj. Po ashtu, gjinisë mashkullore i takojnë të gjithë ata emra që në të shquarën mbarojnë me **i** të theksuar e që shënojnë ndonjë profesion; p.sh.: *sharaxhi-sharraxhija, opâ<sup>o</sup>ηaxhi-opâ<sup>o</sup>ηaxhija, samârxhi-samârxhija, teneçexhi-teneçexhija, burekxhi-burekxhija*. Në gjininë mashkullore bëjnë pjesë edhe emrat e tipit *dash, bu:rr, dja:l, mik, armik, msu:s, bark, zog, breg, mal* etj., të cilët janë mashkullore si nga pikëpamja natyrore, ashtu edhe nga ana gramatikore. Janë mashkullore edhe ata emra që përfundojnë me zanore hundore të tipit – **î**, – **û**; p.sh.: *hî, mullî, hû* etj., si dhe emrat e tipit *thû, prrû, krû, ftû*. Këta të fundit, në trajtën e pashquar dalin me – **û**, kurse të shquarën e formojnë me – **oni**; p.sh.: *thu:-thóni, kru:-króni, ftu:-ftóni* etj.

Kategori e veçantë emrash mashkullore janë ata që në shqipen letrare dalin me zanoren – **ë** fundore; p.sh.: *djalë, burrë, kalë, gurë* etj.; këta shqiptohen pa zanore fundore (për shkak të rënies së saj), prandaj është bërë edhe zgjatja e zanores në trup të fjalës; p.sh.: *dja:l, bu:rr, ka:l, gu:r* etj.

## 1.2. Gjinia femërore

Në rrethin gjuhësor në shqyrtim gjallon një dorë emrash që përdoren vetëm në gjininë femërore dhe lakohen sipas paradigmës së lakimit të tretë; p.sh.: *ppjepën-ppjéna, kryelâ°n-kryelâ°na, ne:r-néra* etj., kurse po këta emra, në pjesë të tjera të të folmeve shqipe përdoren në gjininë mashkullore, ose herë si mashkullore e herë si femërore. Në gjininë femërore natyrore të emrave bëjnë pjesë edhe disa tipa emrash vetjakë (kryesisht të gurrës orientale), që në të shquarën e emërores përfundojnë me zanoren – *i*; p.sh.: *Rukmâ°ni, Ajmâ°ni, Kyméti, Xhylshâhi, Fitanéti* etj. Disa emra femërore dallojnë nga mashkullorët pikërisht për shkak të gjatësisë së tingujve në trup të tyre (gjatësia fonologjike); p.sh.: *plak* (mashkull)-*pla:k* (femër), *mushk* (mashkull)-*mu:shk* (femër), *krushk* (mashkull) – *kru:shk* (femër), *kunat* (mashkull)-*kunâ:t* (femër) etj.

Gjinisë femërore i takojnë edhe emrat e atillë që në të pashquarën dalin me zanoren – *e* ose – *i*; p.sh.: *lúle, núse, téze, shpí, taxhí* etj. Kur kemi të bëjmë me gjininë femërore të emrave, karakteristikë është edhe ndërrimi i gjinisë; disa emra mashkullorësh të numrit njëjës, kur formojnë shumësin, kalojnë në gjininë femërore; p.sh.: *ky mal – któ malíje, ky breg – któ bríxhe, ky shtek – któ shtíxhe, ky vën – któ vëne* etj. Gjinisë femërore i takojnë edhe një tufë emrash që përdoren vetëm në shumës; p.sh.: *któ malíje, któ flók, któ e:n, któ vétulla (vétlla), któ kunra* (këpuçë) etj. Janë në femërore edhe disa emra që në trajtën e pashquar mbarojnë me bashkëtingëllore (për shkak të rënies së zanores fundore – *ë*); p.sh.: *bu:k, mo:ll, pu:n, xhe:ll, su:p, fu:sh, gro:p* etj.

## 1.3. Gjinia asnjane

Gjinia asnjane e emrave në gjuhën shqipe dita-ditës ka ardhur duke u rrudhur, megjithatë në të folmen në shqyrtim ende gjallon një numër i kufizuar asnjanesish, sidomos ata që shoqërohen me përcaktorë. Asnjanes të mirëfilltë janë *ujt* dhe *kry:t*, pra njëjtë si në të folmen e Deçanit<sup>4</sup>. Emri asnjanes *kry:t/kryet* kalon në gjininë femërore gjatë lakimit në gjinore, dhanore e rrjedhore: *i,e kre:s, kre:s, pej kre:s*; në emërore e kallëzore nuk ndërron gjini. Gjinisë asnjane i takojnë edhe disa emra që janë formuar nga substantivimi i mbiemrave (*t' kuçt, t'bárdh, t' zi:t*), si dhe emrat e

<sup>4</sup> Bajram Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë (morfologjia dhe fjalëformimi)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006, f. 38.

formuar nga substantivimi i pjesores së foljes; p.sh.: *t' rritunit, t' msúmit, t' árdhnit, t' pámit, t'shkúmit* etj.

## 1.4. Emrat ambigjenë

Siç u tha më lart, në të folmen e Istogut të gjithë emrat bëjnë pjesë në njërën prej tri gjinive gramatikore, por, po ashtu gjallon edhe lloji i emrave të quajtur ambigjenë (të dygjinishëm), të cilët ndërrojnë gjini gjatë kalimit nga njëjesi në shumës e anasjelltas p.sh.: *mal-má<sup>o</sup>le, breg-bríxhe, shtek-shtíxhe*. Me anë të kësaj rruge ndryshojnë edhe ata emra që shumësin e formojnë me anë të prapashtesës – **na**; p.sh.: *bo:j-bójna, u:j-újna, dry:-dryna, brî-brina* etj. Parë historikisht, dukuria e ndërrimit të gjinisë së emrave është e vjetër, kurse “*në gjuhën letrare ajo është e përgjithësuar dhe është bërë e detyrueshme edhe nga norma*”<sup>5</sup>.

## 1.5. Kategoria e shquarsisë dhe e pashquarsisë

Në të folmen e Istogut mjaft mirë dallohet kategoria e shquarsisë nga ajo e pashquarsisë së emrave, si për nga mjetet gjuhësore (mbaresat), ashtu edhe për nga funksionet sintaksore. Kështu, emrat e gjinisë mashkullore, që në të pashquarën dalin me bashkëtingëlloret okluzive – **k**, – **g**, në të shquarën dalin me zanoren – **u**; p.sh.: *fishëk-fishëku, ÷k-÷ku, mík-míku, plák-pláku, lák-láku, brëg-brëgu, búrg-búrgu, múrg-múrgu, pllúg-pllúgu*. Disa emra mashkullorë, që në të pashquarën dalin me glotalen – **h**, trajtën e shquar e formojnë me mbaresën **i**: *kráh-kráhi, tëh-téhi, shëh-shéhi, plëh-pléhi* etj.

Në disa të folme të gegërishtes verilindore emrat mashkullorë të tipit *káli, magári, déti, drúni, gúri* etj. dalin vetëm në trajtën e shquar, kurse në Istog të njëjtët emra përdoren në të dy trajtat, pra, varësisht nga konteksti i fjalisë; p.sh.: *//Ai e kish ble: nË ka:l* (trajta e pashquar); *Káli i tij e kish kimën e ze:z!* (trajta e shquar) etj. Këta shembuj dhe të tjerë të këtij lloji na bëjnë të pohojmë se nuk është i saktë konstatimi i Idriz Ajetit, kur thekson se “*këta emra në tërë Kosovën shqiptohen vetëm në trajtën e shquar*”<sup>6</sup>.

5 Grup autorësh, *Gramatika I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 92.

6 Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, ASHAK, 1998, f. 19.

## 2. Kategoria e numrit

Pjesa më e madhe e emrave në gjuhën shqipe emërtojnë objekte reale që mund të numërohen, “*prandaj gjuha shqipe njeh dy numra: njëjësin dhe shumësin, të cilët i kundërvihen njëri-tjetrit si me anën e formave të vetë fjalës mal-male, ashtu edhe me anën e fjalëve që përshtaten me emrin në numër: shtëpi e re – shtëpi të reja; kjo shtëpi – këto shtëpi*”<sup>7</sup>. Ky rregull vlen jo vetëm për të folmen e Istogut, por edhe për pjesët e tjera të gegërishtes verilindore

### 2.1. Shumësi i emrave mashkullorë

Në trevën gjuhësore të Istogut shumësi i emrave del mjaft i larmishëm, ndërkaq shumësi i emrave femërorë është më i kufizuar.

### 2.2. Shumësi me – a

Një nga mënyrat e formimit të shumësit të mashkullorëve është kur temës së fjalës në numrin njëjës ia prapavendosim mbaresën e shumësit – **a**. Përhapja e kësaj mbarese tek emrat e përmendur është mjaft e madhe. Emrat, që në gjuhën letrare në shumësin e pashquar mbarojnë me zanoren – **ë**, në Istog dalin me mbaresën **a**, p.sh.: *doktorë (doktorra), profesorë (profesora), inxhinierë (inxhinjera), shoferë (shoferë), autobusë (autobusa), fashistë (fashista)* etj. Me zanoren – **a** e formojnë shumësin edhe ata emra që, në shqipen letrare, janë krijuar me anë prapashtesash të tipit – **s (-ës)**, – **ër**: *njëksa, hjęksa, msu:sa, nįpa, shtýpca, lýpca* etj. Me mbaresën – **a** e formojnë shumësin edhe disa emra mashkullorë që emërtojnë lëndë a materiale të ndryshme, bimë, kafshë, si dhe pjesë a gjymtyrë të trupit; p.sh.: *cúņa, irįca, búņa, bostâona, shotâona, brrýla, krýma, vídha, çarra, krékca* etj. Shumësi me – **a** del edhe tek ata emra që në njëjës dalin me – **an** dhe kanë kuptim përcmues a përbuzës; p.sh.: *búçkâona, mrrólâona, balushâona, drédhâona, hajvâona, rraspillâona, çyrrâona* etj. Një tip tjetër emrash mashkullorë shumësin e formojnë me anë të mbaresës së shumësit – **a**: *púsa, komunista* etj.

<sup>7</sup> Grup autorësh, *Gramatika I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002, f. 94.

### 2.3. Shumësi me – e

Emrat mashkullorë që shumësin e formojnë me mbaresën –*e* janë të tipit *gzim-gzime, idhnim-idhnime, takim-takime, harxhim-harxhime, fitim – fitime, shpërblim-shpërblime, mallkim-mallkime, urim-urime* etj. Në idiomën e Istogut janë mjaft të dendur emrat mashkullorë që në shumës dalin me – *ije*; p.sh.: *mal-malije, shpat – shpatije, gru:n-grunije, shtrat-shtratije, stôm-stômije, grāzhd-grāzhdije, raft-raftije, jāz – jazije* etj.

### 2.4. Shumësi me mbaresë zero

Në Istog me rrethinë disa emra mashkullorësh e krijojnë shumësin si numri njëjës. Që në krye të herës këta emra shumësin e kanë ndërtuar me – *ë* fundore, por, siç dihet, në këtë të folme, kjo zanore në pozitë fundore ka rënë në shqiptim. Tek emrat mashkullorë, që shumësin e formojnë me mbaresë zero, bien në sy disa tipe: a) Emrat që në shumës dalin si njëjësi, duke mos e ndryshuar as theksin: *malsór-malsór, mertek-mertek, puntór-puntór, arsimtar-arsimtar, dru-dru, fërkëm-fërkëm, dāj-dāj, hamar-hamar* etj. b) Emrat që, gjatë kalimit nga njëjësi në shumës dalin me zero mbaresë, por e zgjatin zanoren në trup të fjalës. Ndodh kështu kryesisht me emrat mashkullorë, që formohen me prapashtesën – *ak,l-ek* dhe në trajtën e pashquar mbarojnë me – *k*, pra, kur bashkëtingëllorja *k* nuk palatalizohet në palatalen *q*, përkatësisht në afrikaten *ç*, si *dyrek-dýrek, pishak-píshak* etj. Siç kemi vënë re, format e tilla të mashkullorëve në shumës gjenden edhe në të folmen e Deçanit <sup>8</sup> e në ndonjë të folme tjetër. Në Istog gjallon një tip emrash të gurrës orientale, që gjatë kalimit nga njëjësi në shumës nuk ndryshojnë: *dervish-dervish, subash-subash, kadí-kadí, haxhí-haxhí* etj. Edhe emrat e tipit *prizrenalí, kojshí, mitrovicalí, prishtinalí* e ndonjë tjetër kanë trajtë të njëjtë për të dy numrat.

### 2.5. Shumësi me palatalizim

Një numër i konsiderueshëm emrash mashkullorë, që në njëjës mbarojnë me bashkëtingëlloret – *k,-g, – ll, – n*, shumësin e formojnë me anë të palatalizimit (përkatësisht të afrikatizimit) të bashkëtingëlloreve fundore, si *mik-miç, zog-zoxh* (por edhe *zof*), kurse në disa raste vihet re

8 Bajram Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë (morfologjia dhe fjalëformimi)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2006, f. 46.

edhe formimi i shumësit me anë të jotizimit: *duk-du:j, bull-bu:j*. Me anë të jotizimit formohet edhe shumësi i emrave mashkullorë që në njëjës mbarojnë me zanore hundore, si *gû – guj, hûj-huj, pê-pêj* etj. Po ashtu vihet re edhe tipi i emrave, që në njëjës dalin me – **nl-ŋ**, ndërkaq, shumësin e formojnë me anë të zanores – **a**; p.sh.: *cûŋ-cûŋa, bûŋ-bûŋa, zeshkan – zeshkâ<sup>o</sup>na, galan-galâ<sup>o</sup>na, mrrölan-mrrólâ<sup>o</sup>na* etj. Me interes gjuhësor është edhe tipi i emrave mashkullorë që shumësin e bëjnë me anë të palatalizimit, duke shtuar edhe nyjën shquese – **i**: *krushk-krushç (i), peshk-peshç (i), brisk-brisç (i)* etj. Përveç shembujve të përmendur, kemi vënë re edhe mënyrat e formimit të shumësit me anë të prapashtesave – **ŋn** dhe –**na**: *dreç-dreçën, vlla – vllazën, shat-shytën, bri-brina, mäll-mällna, ba:r-bárna, drith-drithna* etj. Në arealin gjuhësor të Istogut, ashtu si edhe në disa të folme të tjera të gegërishtes verilindore, vihet re tipi i emrave mashkullorë që, shumësin e formojnë me anë të dukurisë së metafonisë; p.sh.: *kulaç-kuleç, tarak-tareç, dash-desh, mzat-mzet* etj.

## 2.6. Shumësi i emrave femërorë

Formimi i kësaj gjinie emrash, në krahasim me mashkullorët, është më i kufizuar. Me mbaresën – **a** e formojnë shumësin disa emra femërorë që dalin me – **ër**, – **ërr**, – **ën**, – **ël**, – **ull**; p.sh.: *letër-lëtra, motër-mótra, lpetër-lpëtra, kókërr-kókrra, mjékërr-mjékrra, gógël-gógla, cükël-cükla, hátull-hátilla, vétull-vétilla, pétull-pétilla, nërse:tull-nërsétilla* etj. Siç mund të shihet në shembujt e dhënë, emrat femërorë gjatë kalimit nga njëjësi në shumës e humbasin zanoren në trup të tyre (*petull-petlla, flutur-flutra* etj.). Një tip tjetër emrash femërorë, që në njëjës mbarojnë me zanoren e theksuar – **i**, në shumës marrin mbaresat – **a** ose – **ja**; p.sh.: *lejthí – lejthía, shpí – shpíja, thmí – thmíja, tepsí – tepsía, burgí – burgíja, kojshí – kojshía, mantí – mantíja, flí – flíja, alltí-alltíja* etj. Me mbaresën – **a** shumësin e formojnë edhe disa emra femërorë që janë krijuar me anë prapashtesash të ndryshme; p.sh.: *mlo:js-mlójsa, çiro:js-çirójsa, kullo:js-kullójsa, grry:s-grrýsa, fshi:s-fshísa, natrre:s-natrrésa* etj.; kurse disa të tjerë shumësin e formojnë me anë të mbaresës – **na**; p.sh.: *u:j-újna, ko:h-kóhna, e:r-érna, lo:j-lójna, shi:-shína* etj. Disa nga emrat e tillë, gjatë kalimit nga njëjësi në shumës, nuk ndryshojnë, pra, ashtu siç ngjet edhe me disa mashkullorë; p.sh.: *dít-dít, ja:v, ja:v, kafsha:t-kafsha:t, de:k-de:k* (vdekja), *ŋujóre-ŋujóre, maxhetóre-maxhetóre, akullóre-akullóre, katunóre-katunóre, nxheshatóre-nxheshatóre* etj. Në këtë kategori emrash bëjnë pjesë edhe emrat abstraktë që janë formuar nga pjesorja e foljes me anë të prapashtesës – **me**; p.sh.: *d bléme, t*

*ráme, t páme, t kçyrne, t'pjékne* etj., kurse emrat femërorë të tipit *de:r, do:r, gru:* etj. shumësin e formojnë me anë të kontraksionit të zanoreve: *de:r-dy:r* (*e>y*); *do:r – du:r* (*o>u*), *gru:-gra* (*u>a*).

## 2.7. Shumësi i emrave asnjanës

Emrat asnjanës prejfoljorë të tipit *t' bërtitnit, t' iknit, t' nxhëshnit, t' écnit, t' hâ°grit, t' pímit* etj., por edhe ata prejmbiemërorë të tipit *t' zít, t' këçt* etj., nuk kanë numër shumësi, sepse kur përdoren në shumësi kalojnë në gjininë femërore; megjithëkëtë, këtu vihen re edhe përdorimet paralele të gjinisë femërore, si: *dý t' bërtítne, dý t' íkme, dý t' nxhëshme, dý t' écme, dý t' hâ°grye, dý t' píme* etj.

Kur kemi të bëjmë me emrin përgjithësisht e konkretisht me numrin e tij, hetohen edhe disa lloje, që përdoren vetëm në njëjës (*singularia tantum*): a) Disa emra që tregojnë lëndë të panumërueshme: *sheçëri, úfla, tà°mli, kósi* etj.; b) emrat e ashtuquajtur përmbledhës: *rini-a, granim-i, robnim-i* etj.; c) emra që shënojnë nocione kohore, si ditët e javës e stinët e vitit: *e hâ°ne, e éjte, e dílle, pranvëra, vjështa, dímní* etj.; ç) emra sëmundjesh dhe virusesh të ndryshme: *carilláku, kancëri, píka n' trú, tifúzi, malárja* etj.; d) emra që tregojnë dukuri atmosferike të natyrës: *zhëgu, flládi, lagshtëja, thatsíja* etj. Përveç njëjësit, vihet re edhe tipi i emrave që dalin vetëm në shumësi (*pluralia tantum*): “emrat e kësaj kategorie, më tepër tregojnë shumësi dhe rëndom nuk shprehin ndonjë shumicë të thjeshtë të numërueshme”<sup>9</sup> dhe varësisht prej asaj se çka shënojnë, mund të jenë: a) Emra që tregojnë gjymtyrë të trupit, veshmbathje a mjete të punës: *böth, flókt, mustëçe, pantólla, tírçi, sýza, gërshâ°n, dá° na* etj.; b) disa emra abstraktë që tregojnë kohën e kryerjes së një pune a veprimi: *t' zhdjérgat, t' mjéllat, t' kórrat, t' shtátat* etj.

Emrat e tipit *pluralia tantum* mjaft dendur dalin edhe te toponimia, përkatësisht te mikrotoponimia e trevës së Istogut; p.sh.: *Gúrrat e Bárðha* (kroje në bjeshkët e fshatit Cerrcë), *Ramadâ°net* (fusha dhe kulloja në fshatin Prigodë), *Veshhtëjet* (mikrotoponim në fshatin Lubovë dhe Orroberdë), *Rrásat* (mikrotoponim në bjeshkët e fshatit Suhogerllë) etj.

9 Fatmir Agalliu, *Emrat që përdoren vetëm në shumësi në gjuhën shqipe*, në: “Çështje të fonetikës dhe të gramatikës...”, Tiranë, 1972, f. 63-65.



### 3. Rasat

Idioma e Istogut ka pesë rase (*emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore*), por mjaft shpesh del edhe rase *thirrërore*. Kur kemi të bëjmë me arsyet e reduktimeve që ka pësuar sistemi rasor i shqipës, studiuesi Shaban Demiraj pohon se

*“...kjo ka ardhur si rezultat i paafësisë së trajtave të rasave për të shprehur gjithë lidhjet sintaksore të emrit në procesin e komunikimit, e për pasojë, shfaqjen e parafjalëve si mjet precizimi të lidhjeve e raporteve të caktuara në njësitë e komunikimit; së dyti, te evolucioni i tingujve fundor, dhe në fund, te veprimi rrafshues i analogjisë”<sup>10</sup>.*

#### 3.1. Rasat gjinore – dhanore

Emrat mashkullorë në këto rase, në trajtën e pashquar, dalin me mbaresat – **i** dhe – **u**: *i në djáli, i në zógu, i në mtku, në míku (i,e), ni brégu (i,e)*; ndërsa femëroret, në trajtën e pashquar, dalin me mbaresat – **s** dhe – **i**: *i në çíks (por edhe i në çíke), në çíke (i,e), në grúje (i,e)* etj. Shumësi i pashquar në këto rase del dyfarësh: me mbaresën – **e** dhe me **v** epentetike: *i lísav (por edhe i lísave), i,e krójeve, núsev (e)* etj., ndërkaq pa **v** epentetike del një numër i kufizuar emrash të tipit si: *tâ°mli dhéne, hínllíma kuale, atyme xhíne, pu:n çubâ°one, para dō vjéte*. Kemi vënë re se disa nga këta emra dalin me **v** epentetike: *llçítu kuálve taxhí se kēmi me shkú n°mal!!! Xhinve duhet me ju kallxú çí néstra po e bâ°jm djálin synet!!!* etj.

#### 3.2. Rase kallëzore

Emrave mashkullorë, që në trajtën e pashquar të emërores dalin me bashkëtingëllore, në të shquarën kallëzore u shtohet mbaresa – **n**: *obórrí (n), çóshi (n), drúni(n), xhárpní(n)* etj. Po ashtu edhe disa emra mashkullorë, që në të pashquarën e emërores dalin me njërën nga zanoret e theksuara të tipit – **a**, – **e**, – **i**, por që u shtohet edhe mbaresa rasore – **n**: *vlláun, shún, dhéun* etj. Në kallëzore edhe disa emra kafshësh, që në numrin njëjës dalin me temë në – **j**, marrin mbaresën – **n**: *larójin, kuçójin, murrójin, sharójin* etj., si dhe një dorë emrash vetjakë të gjinisë mashkullore, që në trajtën e pashquar dalin me temë në zanore të gjatë (të theksuar): *Sejdi:n, Sadri:n, Gani:n, Sabri:n, Elmín, Shefki:n* etj.

### 3.3. Rasa rrjedhore

Emri në këtë rasë në të folmet e gjuhës shqipe del me trajta të larmishme. Kështu ngjet edhe në të folmen në shqyrtim. Emrat njëjës të gjinisë femërore në rasën rrjedhore kanë trajtë të njëjtë me kallëzoren dhe gjinoren, kurse në rrjedhore dalin me mbaresat – *e* dhe – *s*: *pej bjëshks, dárdhs, pej mótrës, pej tézes, pej mënjes* etj.; mirëpo, kur emrat e rrjedhores nuk shoqërohen me parafjalën *pej*, atëherë ata dalin me – *e* fundore: *vó púle, tâ<sup>o</sup>mël lôpe, co:p tóke, bu:k thékne* etj. Për sa u përket trajtave të rrjedhores me – *et*, që hasen dendur në të folmet veriore, ato nuk vihen re në Istog. Një tufë emrash në rasën rrjedhore dalin përmes dy formash: a) Emrat që dalin me mbaresën – *ve* dhe janë më të shumtë në numër; b) emrat që dalin me mbaresën –*sh*; p.sh.: *//ky u:j buron pej lísavell t mirën mos e prit pej armiçvell raki dárdhashll e kápi për krahsll e zhagíti për flókshll* etj. Në disa raste rasa rrjedhore përdoret në funksion të emërores ose të kallëzores; p.sh.: *shkoj pej Péje (shkoi në Pejë)// U nis çanej pej shpije (shkoi në shtëpi)//* etj.

### 3.4. Rasa thirrrore

Siç e thamë edhe në një rast tjetër, thirrvoja është prej rasave që në shqipen e sotme nuk gjen përdorim formal dhe nuk shpreh kuptim të pavarur, por vetëm në kuadër të kontekstit, mirëpo kjo nuk mund të thuhet edhe për arealin gjuhësor të Istogut, sepse aty kemi vënë re se kjo rasë gjallon ende, në ato raste kur dikush e thërret dikë a i drejtohet ndonjërit për ndonjë kërkesë a nevojë që ka. Ajo ka trajtën e emërores së pashquar, vetëm se këtu shoqërohet me pasthirrat përkatëse për të dyja gjinitë; për mashkullorë: *o, ore, more*; ndërkaj, për femëroren përdoren pasthirrat *oj, moj, mori*; p.sh.: *//O djalo-ohutu more/ se na nxuni nà<sup>o</sup>ta// Oj çikol moj po a po nî:n moril bîna dô u:j t fióft oj//* etj. Në Istog vihen re edhe ndërtime e trajta të tjera të rasës thirrrore, si: pasthirrmë + përemër vetor a mbiemër + e pashquara e emërores: *//Ore ti dja:ll këçyre punën tâ<sup>o</sup>ne// O ju thmija mos na bôni zhu:rm//* etj. Përveç trajtave të përmendura për ndërtimin e thirrores, hetohen edhe disa raste kur format e thirrores dalin pa pasthirrma e pa pjesëza përkatëse, p.sh.: *Isuf!// Adem!!! Hatixhe!!! Mîxha Avdyll mûle se po t thrrásin!//* etj.

## 4. Lakimi

Shumica e gramatikave të shqipes bëjnë fjalë për katër lakime të emrave, kurse klasifikimi i tyre është bërë sipas parimeve të ndryshme. Sidoqoftë, edhe në idiomën gjuhësore në shqyrtim, ndryshimet a format që marrin emrat gjatë lakimit nuk dallojnë shumë prej të folmeve fqinjësore e më gjerë. Në këtë rrafsh, duke u mbështetur në mbaresat rasore, emrat klasifikohen në katër lakime:

a) **Në lakimin e parë**, që është më i pasuri, përfshihen emrat mashkullorë, që në të shquarën e emërores marrin njëjën shquese – **i**, kurse në rasën gjinore, dhanore e rrjedhore marrin mbaresën –**it**: *lis-i, plis-i, ah-i, dja:l-i, bu:rr-i, gru:n-i, zhgÿn-i* etj. Këtij lakimi i takojnë edhe disa emra të gjinisë femërore, që në trajtën e shquar dalin me njëjën shquese –**i**: *Hatmon-i, Rukmon-i* e ndonjë tjetër. Po ashtu, në lakimin e parë bëjnë pjesë edhe një kategori emrash, dikur të gjinisë asnjënjësore, si : *mishi, vëshi, tãomli* etj. Që të kemi një pasqyrë më të plotë në lidhje me lakimin e parë, më poshtë po paraqesim disa emra të këtij lakimi, në të dyja trajtat dhe në të dy numrat (gjatë lakimit trajta e shquar e emrit do të vihet në kllapa). Paradigma e lakimit të emrit *djalë (dja:l)* në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e numrit njëjës dhe shumës<sup>11</sup>:

	Numri njëjës	Numri shumës
Emërore (E.)	<i>nÿ dja:l (djáli)</i>	<i>dõ djel (djelt)</i>
Gjinore (Gj.)	<i>nÿ djáli (djálit)</i>	<i>dõ djelve (djelve)</i>
Dhanore. (Dh.)	<i>nÿ djáli (djálit)</i>	<i>dõ djelve (djelve)</i>
Kallëzore (Kall.)	<i>nÿ dja:l (djálin)</i>	<i>dõ djel (djelt)</i>
Rrjedhore (Rrjedh.)	<i>pej nÿ djáli (djálit)</i>	<i>dõ djelve</i>

Paradigma e lakimit të emrit *lis* në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e numrit njëjës dhe shumës.

	Numri njëjës	Numri shumës
E.	<i>nÿ lis (lísi)</i>	<i>dõ lísa (lísat)</i>
Gj.	<i>nÿ lísi (lísit)</i>	<i>dõ lisav/lísave (lísav/lísave)</i>
Dh.	<i>nÿ lísi (lísit)</i>	<i>dõ lisav/lísave (lísav/lísave)</i>
Kall.	<i>nÿ lis (lísin)</i>	<i>dõ lísa (lísat)</i>
Rrjedh.	<i>nÿ lísi (lísit)</i>	<i>dõ lísave (lísave)</i>

11 Shënim: Me qëllim që të mos ngarkohet paradigma, aty nuk i kemi shënuar trajtat e shkurtra e as rasën thirrrore, që gjën përdorim në të folmen që po trajtojmë.

Më poshtë po paraqesim paradigmën e lakimit të emrave të paranyjzuar: *i shoq* / *i shoqi* dhe *i vllaj* etj.

	Numri njëjës	Njëjësi	shumësi
Em.	<i>i shoq (i shóqi)</i>	<i>i vllaj</i>	-----
Gj.	<i>t'shojt (t' shóçit)</i>	<i>d vllaut</i>	<i>d vllázniv (e)</i>
Dh.	<i>t'shojt (t' shóçit)</i>	<i>d vllaut</i>	<i>d vllázniv (e)</i>
Kall.	<i>t'shojn (t'shóçin)</i>	<i>d vlláun</i>	<i>vlláznit</i>
Rrjedh.	<i>t' shojt (t' shóçit)</i>	<i>Pej d vllaut</i>	<i>pej d vlláznive</i>

b) **Në lakimin e dytë** bëjnë pjesë disa emra mashkullorësh që në trajtën e pashqar të rasës emërore dalin me zanore të theksuar, kurse kur shquhen mbarojnë me zanoren – **u**. Emrat e tillë, tutje, në rasat gjinore, dhanore e rrjedhore të numrit njëjës dalin me – **ut**: *kà, shí, thí, dhé, vllà*. Në këtë lakim bëjnë pjesë edhe disa emra mashkullorësh, që në trajtën e pashqar dalin me bashkëtingëlloret – **g**, – **k**: *breg, shtek* (në shqipen standarde: *shteg*).

Paradigma e lakimit të emrit *thí* në trajtën e shqar dhe në të pashqarën e numrit njëjës dhe shumë:

	Numri njëjës	Numri shumë
Em.	<i>nǐ thí (thíu)</i>	<i>dǒ thí (thí:t)</i>
Gj.	<i>nǐ thíu (thíut)</i>	<i>dǒ thíve (thíve)</i>
Dh.	<i>nǐ thíu (thíut)</i>	<i>dǒ thíve (thíve)</i>
Kall.	<i>nǐ thí (thíun)</i>	<i>dǒ thí (thí:t)</i>
Rrjedh.	<i>nǐ thí (thíut)</i>	<i>dǒ thíve (thíve)</i>

Paradigma e lakimit të emrit *breg* në trajtën e shqar dhe në të pashqarën e njëjësit dhe shumësit:

	Numri njëjës	Numri shumë
Em.	<i>nǐ breg (brégu)</i>	<i>dǒ bríxhe (bríxhet)</i>
Gj.	<i>nǐ brégu (brégut)</i>	<i>dǒ bríxheve (bríxheve)</i>
Dh.	<i>nǐ brégu (brégut)</i>	<i>dǒ bríxheve (bríxheve)</i>
Kall.	<i>nǐ breg (brégun)</i>	<i>dǒ bríxhe (bríxhet)</i>
Rrjedh.	<i>nǐ brégu (brégut)</i>	<i>dǒ bríxheve (bríxheve)</i>

c) **Në lakimin e tretë** bëjnë pjesë disa emra të gjinisë femërore dhe disa mashkullorë që në numrin njëjës të rasës emërore, trajta e shquar, marrin nyjën shquese – **al-ja**, kurse në rasat e tjera, përkatësisht në gjinore, dhanore e rrjedhore, dalin me bashkëtingëlloren – **s**: *nâ<sup>o</sup>na, môtra, dita, nâ<sup>o</sup>ta, Râ<sup>o</sup>ma, Fazlîja, dâja, lûlja* etj. Emrat e këtij tipi, në rasat e zhdrejta të trajtës së pashquar, dalin me mbaresën – **e**: *i, e në dite, pej në dite* etj.

Paradigma e lakimit të emrit *ditë (di:t)* në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e njëjësit dhe shumësit:

	Numri njëjës	Numri shumës
Em.	<i>nî dît (dita)</i>	<i>dô dît (ditt)</i>
Gj.	<i>nî dite (dit's)</i>	<i>dô ditve (ditve)</i>
Dh.	<i>nî dite (dit's)</i>	<i>dô ditve (ditve)</i>
Kall.	<i>nî dît (dîtën)</i>	<i>dô dît (ditt)</i>
Rrjedh.	<i>nî dite (dit's)</i>	<i>dô ditve (ditve)</i>

Paradigma e lakimit të emrit *dajë (da:j)* në trajtën e shquar dhe në të pashquarën e njëjësit dhe të shumësit:

	Numri njëjës	Numri shumës
Em.	<i>nî da:j (dâja)</i>	<i>dô dâj (dâjt)</i>
Gj.	<i>nî dâje (dâj's)</i>	<i>dô dâjve (dâjve)</i>
Dh.	<i>nî dâje (dâj's)</i>	<i>dô dâjve (dâjve)</i>
Kall.	<i>nî da:j (dâjën)</i>	<i>dô dâj (dâjt)</i>
Rrjedh.	<i>nî dâje (dâj's)</i>	<i>dô dâjve (dâjve)</i>

c) **Në lakimin e katërt** bëjnë pjesë emrat e gjinisë asnjënjësore, pra, ashtu si në të folmet e tjera të gjuhës shqipe. Shumica e emrave të dikurshëm asnjënjës tani janë mashkullorë e shumë pak femërorë. Asnjënjësit sot dalin shumë të kufizuar dhe në të shumtën e rasteve shoqërohen me përcaktorët e asnjënjësisë; p.sh.: //kta tâ<sup>o</sup>mëll/ kta mish/ kta kryp/ kta t' nxe:t/ kta kry:/ kta t' ftoft// etj.

Paradigma e lakimit të emrave asnjans *hta u:j* dhe *hta tã°mêl*:

	<i>Kta u:j</i>	<i>Kta tã°mêl</i>
Em.	<i>hta u:j</i>	<i>hta tã°mêl</i>
Gj.	<i>ktí úji</i>	<i>ktí tã°mli</i>
Dh.	<i>ktí úji</i>	<i>ktí tã°mli</i>
Kall.	<i>hta u:j</i>	<i>hta tã°mêl</i>
Rrjedh.	<i>ktí úji</i>	<i>ktí tã°mli</i>

Paradigma e lakimit të emrit asnjans *hta t fiõft*, në trajtën e pashquar dhe në atë të shquar:

	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Em.	<i>hta (dõ) t fiõft</i>	<i>T fiõftit</i>
Gj.	<i>kti (dõ) t fiõfti</i>	<i>T fiõftit</i>
Dh.	<i>kti (dõ) t fiõfti</i>	<i>T fiõftit</i>
Kall.	<i>hta (dõ) t fiõft</i>	<i>T fiõftin</i>
Rrjedh.	<i>kti (dõ) t fiõfti</i>	<i>T fiõftit</i>

## Përfundime

Nga sa u tha më lart në këtë punim, mund të arrihet në përfundimet se për sa i përket truallit gjuhësor të Istogut, të gjithë emrat i takojnë njëres prej gjinive gramatikore. Në të folmen në shqyrtim ende gjallon një numër i kufizuar asnjansish, sidomos ata që shoqërohen me përcaktorë. Asnjans të mirëfilltë janë *ujt* dhe *kry:t*, pra njësoj si në të folmen e Deçanit e në ndonjë të folme tjetër. Emri asnjans *kry:t/kryet* kalon në gjininë femërore gjatë lakimit në gjinore, dhanore e rrjedhore: *i, e kre:s, kre:s, pej kre:s*; në emërore e kallëzore nuk ndërron gjini. Gjinisë asnjansë i takojnë edhe disa emra që janë formuar nga substantivimi i mbiemrave (*t' kuçt, t' bårdh, t' zi:t*), si dhe emrat e formuar nga substantivimi i pjesores së foljes; p.sh.: *t' rritunit, t' msúmit, t' árdhnit, t' pámit, t' shkúmit* etj.

Emrat mashkullorë të tipit *káli, magári, déti, drúni, gúri* etj. përdoren në të dy trajtat, pra, varësisht nga konteksti i fjalisë; p.sh.: *//Ai e kish ble: nì ka:l* (trajta e pashquar); *Káli i tij e kish kimën e ze:z!* (trajta e shquar) etj.

Idioma e Istogut ka pesë rasa (*emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore*), por mjaft shpesh del edhe rasa *thirrore*, pra kjo rasë gjallon ende, në ato raste kur dikush e thërret dikë a i drejtohet ndonjërit për ndonjë kërkesë a nevojë që ka. Ajo ka trajtën e emërores së pashquar, vetëm se këtu shoqërohet me pashirrrmat përkatëse për të dyja gjinitë; për mashkullore: *o, ore, more*; ndërkaq, për femëroren përdoren pashirrrmat *oj, moj, mori*; p.sh.: // *O djalo-oljutu more! se na nxuni nëtall! Oj çikol moj po a po nî:n mori/ bîna dō u:j t fîōft oj!* etj. Në Istog vihen re edhe ndërtime e trajta të tjera të rasës thirrore, si: pashirrmë + përemër vetor a mbiemër + e pashquara e emërores: // *Ore ti dja:ll këyre punën tânne! O ju thmija mos na bōni zhu:rm!* etj. Përveç trajtave të përmendura për ndërtimin e thirrores, hetohen edhe disa raste kur format e thirrores dalin pa pashirrrma e pa pjesëza përkatëse, p.sh.: *Isuf!!! Adem!!! Hatixhe!!! Mîxha Avdyll! mûle se po t thrrâsin!* // etj.

## Bibliografia

1. Fatmir Agalliu, *Emrat që përdoren vetëm në shumës në gjuhën shqipe*, në: “Çështje të fonetikës dhe të gramatikës...”, Tiranë, 1972.
2. Mehmet Ahmetaj, *E folmja e Plavës dhe e Gucisë*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2002.
3. Idriz Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, ASHAK, 1998.
4. Imri Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.
5. Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, “Rilindja”, Prishtinë, 1988.
6. Shaban Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1972.
7. Grup autorësh, *Gramatika I*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
8. Bajram Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, morfologjia dhe fjalëformimi, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2006.
9. Ukë Xhemaj, *Etnokultura shqiptare në Podgur*, monografi etnologjike, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2003.